



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 9, datë 13.01.2011

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË SHOQËRINË E BROKERIMIT
“BROKER GABA” SH.A

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14 pika 6/n, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime”, i ndryshuar, VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës” me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Shoqëria “Broker Gaba” sh.a, ushtron veprimtari brokerimi në sigurime për klasat e jo-jetës, me Licencën nr. 6, datë 19.03.2010, miratuar me Vendimin nr. 30 datë 19.03.2010. Aksionar i vetëm i shoqërisë është Z. Muhamed Gaba, i cili zotëron 5.000 aksione me vlerë nominale prej 1.000 lekë secili.

Me shkresën nr. 1609, datë 22.09.2010 dhe nr. 1705, datë 15.10.2010, nga ana e shoqërisë së brokerimit “Broker Gaba” sh.a është depozituar njoftimi për ndryshim të aksionarit të shoqërisë dhe vendimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë i datës 14.09.2010, për shitjen 100% të aksioneve të shoqërisë, Z. Hysen Ruka. Me shkresën nr. 1653, datë 05.10.2010, është depozituar gjithashtu një kërkesë për miratimin e ndryshimeve të shoqërisë “Broker Gaba” sh.a dhe Vendimi i aksionarit të vetëm Z. Ruka, datë 27.09.2010, në të cilin është vendosur:

- a) Emërtimi i ri i shoqërisë nga “Broker Gaba” sh.a ndryshon në “Bindi Insurance Broker” sh.a;

- b) Selia e shoqërisë të ndryshojë nga Rr. “Dervish Hima”, Tiranë, në Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Sky Tower, 6/1, Tiranë;
- c) Lirimi nga detyra të Z. Ilir Alushi si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe emërimin në vend të tij të z. Hysen Ruka në cilësinë e Kryetarit;
- d) Lirimi nga detyra të Z. Eduart Veliaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe emërimin në vend të tij të Z. Stephen Barclay Strauss në cilësinë e Zv/Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës;
- e) Lirimi nga detyra të Z. Muhamed Gaba si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe emërimin në vend të tij të Z. Altin Saliasi në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës.

Për sa më sipër, Autoriteti,

V E N D O S I :

1. Miratimin e transferimit të paketës kontrolluese në masën 100% të shoqërisë së brokerimit “Broker Gaba” sh.a, tek aksioneri Hysen Ruka.
2. Miratimin e emërimit të ri të shoqërisë “Bindi Insurance Broker” sh.a.
3. Miratimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës me përbërje si më poshtë:
 - Z. Hysen Ruka - Kryetar
 - Z. Stephen Barclay Strauss - Nënkryetar
 - Z. Altin Saliasi - Anëtar
4. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI